Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 6 prill 2012

Lënda nr. 246/09

Stevan SIMOVIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 6 prill 2012, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në përputhje me rregullën 13 § 2 të Rregullores së tij të punës, vendosë si në vijim

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 13 prill 2009, dhe është regjistruar më 30 prill 2009.

2. Më 23 dhjetor 2009, Paneli kërkoi nga ankuesi informata të tjera. Nuk është marrë ndonjë përgjigje.

3. Më 9 janar 2012 Paneli ia komunikoi lëndën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) me qëllim të marrjes së komenteve të UNMIK-ut për pranueshmërinë e lëndës.

4. Më 23 shkurt 2012, UNMIK-u dha përgjigjen e vet.

II. FAKTET

5. Ankuesi është babai i z. Aleksandar Simoviq.

6. Ankuesi thotë se djali i tij, i punësuar si gazetar dhe përkthyes në radiostacionin "Media Action International", është kidnapuar nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) më 21 gusht 1999 në Prishtinë.

7. Ankuesi thotë se kidnapimi është raportuar menjëherë tek Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK), KFOR-i, UNMIK-u dhe tek Zyra e Prokurorit Ndërkombëtar në Prishtinë. Ankuesi më tej thotë se në një datë të pasaktësuar, ai ka kërkuar që "forca dhe policia ndërkombëtare" ta përcjellin dhe t'i drejtohen komandantit të UÇK-së, për të cilin pretendonte se ishte i përfshirë në kidnapimin e djalit të tij, mirëpo ata refuzuan ta bëjnë një gjë të tillë.

8. Mbetjet mortore të z. Aleksandar Simoviq janë zbuluar nga UNMIK-u më 5 qershor 2001 në Gllogoc. Ato janë identifikuar dhe i janë dorëzuar familjes më 1 nëntor dhe me 15 nëntor 2002. Në bazë të certifikatës së vdekjes, të lëshuar nga Njësia për persona të zhdukur e Policisë së UNMIK-ut, shkaku i vdekjes z. Aleksandar Simoviq nuk ishte përcaktuar.

9. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi, dhe Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së kryetarit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), ku mirëpritej angazhimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë. Mes datës 9 dhjetor 2008 dhe 30 mars 2009, të gjitha lëndët penale që mbaheshin nga Departamenti i drejtësisë i UNMIK-ut dhe nga Policia e UNMIK-ut, iu dorëzuan homologëve të EULEX-it.

III. ANKESA

10. Ankuesi ankohet për dështimin e pretenduar të UNMIK-ut që të bëjë hetimin e duhur të zhdukjes dhe vrasjes së djalit të tij.

11. Paneli konsideron se ankuesi mund të thuhet se thirret në shkeljen e së drejtës për jetë të djalit të tij, e cila garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj).

IV. LIGJI

12. Para shqyrtimit të lëndës për bazueshmërinë e saj, Paneli fillimisht duhet të vendosë nëse duhet të pranohet lënda apo jo, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë, të parapara në nenin 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

13. Në esencë, ankuesi pohon se nuk ka pasur hetim të duhur penal për zhdukjen dhe vrasjen e djalit të tij.

14. Në komentet e tij, PSSP-ja argumenton se përmes një hetimi të duhur UNMIK-u ka qenë në gjendje të gjejë dhe të identifikojë mbetjet mortore të z. Aleksandar Simoviq, duke plotësuar kështu njërin prej kushteve procedurale, të parapara në nenin 2 të KEDNj-së, gjegjësisht obligimin për realizimin e hetimit, përmes të cilit do të përcaktohej fati dhe vendndodhja e personit të zhdukur. Për më tepër, pasi që procedura e identifikimit dhe e dorëzimit të mbetjeve mortore është përfunduar në nëntor të vitit 2002, PSSP-ja është mendimit se ankesa lidhur me aspektin e lartpërmendur të nenit 2 është jashtë juridiksionit të Panelit, si *ratione materiae,* ashtu edhe *ratione temporis*.

15. Nga ana tjetër, PSSP-ja pranon se ankesa është e pranueshme *prima facie* përkitazi me kushtin tjetër procedural të nenit 2 të KEDNj-së, gjegjësisht me obligimin për të kryerjen e hetimit, përmes të cilit do të përcaktohej "nëse ka pasur zhdukje të paligjshme që do të rezultonte me identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës për zhdukje dhe vrasje" të z. Aleksandar Simoviq.

16. Paneli konstaton se PSSP-ja bën dallimin mes këtyre dy kushteve të procedurës, të parapara në nenin 2 të KEDNJ-së. Kështu, ai konsideron se aktivitetet e gjetjes dhe identifikimit të mbetjeve mortore të personit të zhdukur mund të konsiderohen si komponent i pavarur i obligimit procedural, të paraparë në nenin 2 të KEDNj-së.

17. Sa i përket kësaj çështjeje, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, përmes së cilës përcaktohen standardet e hetimit të efektshëm të vrasjeve dhe zhdukjeve në rrethana kërcënuese për jetë. Gjykata Evropiane deklaron se "qëllimi thelbësor i hetimit të tillë është sigurimi i zbatimit të efektshëm të ligjeve vendore që mbrojnë të drejtën në jetë..." (shih, p.sh., Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) (Dhoma e lartë), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/09 dhe të tjerët, aktgjykim i datës 18 shtator 2009, § 191). Posaçërisht në rastin e personave të zhdukur që më vonë gjenden të vdekur, Gjykata ka konstatuar se procedurat e zhvarrimit dhe të identifikimit të mbetjeve mortore nuk shterin obligimin e paraparë në nenin 2 të KEDNJ-së. Është e vërtetë se Gjykata konsideron se "obligimi procedural që rezulton nga zhdukja në përgjithësi mbetet derisa vendndodhja dhe fati i personit nuk dihen, dhe rrjedhimisht është i karakterit vazhdues" (GjEDNj, *Paliq kundër Bosnjë dhe Hercegovinës* nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, § 46; në të njëjtin kuptim GjEDNj (Dhoma e lartë), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lartë, në § 148). Megjithatë, Gjykata po ashtu thekson se ky obligim procedural "nuk përfundon madje edhe pas zbulimit të kufomës...Kjo vetëm hedh dritë në një aspekt të fatit të personit të zhdukur, ndërsa obligimi për të vërtetuar zhdukjen dhe vdekjen, si dhe për identifikimin dhe ndjekjen penale të kryerësit të veprave të paligjshme, në përgjithësi mbetet" (GjEDNj, *Paliq kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, cituar më lartë, në § 46; në kuptimin e njëjtë GjEDNj (Dhoma e lartë), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lartë, në § 145). Ky obligim procedural sipas nenit 2 të KEDNj-së duhet rrjedhimisht të konsiderohet si obligim i vetëm. Ndërsa gjetja dhe identifikimi pasues i mbetjeve mortore të viktimës në vetvete mund të jenë të arritura domethënëse, obligimet procedurale sipas nenit 2 vazhdojnë të ekzistojnë (shih GjEDNj, *Paliq kundër Bosnjë Hercegovinës,* cituar më lartë, në § 64).

18. Për këto arsye, Paneli nuk do ta ndajë obligimin për zbatimin e hetimit, përmes të cilit do të përcaktohej fati dhe vendndodhja e personit nga obligimi për realizmin e hetimit, përmes të cilit do të përcaktohej nëse ka pasur zhdukje të paligjshme që do të çonte te identifikimi dhe dënimi i personave përgjegjës për zhdukje dhe vdekje të viktimës. Paneli do të vazhdojë punën në bazë të obligimit të vetëm vazhdues. Është e qartë se fakti se mbetjet mortore të z. Aleksandar Simoviq janë gjetur dhe identifikuar është element i rëndësishëm që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të përgjithshëm të plotësimit të obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNj-së.

19. Rrjedhimisht, ankesa nuk mund të shpallet pjesërisht e papranueshme në bazë të asaj se është pjesërisht jashtë juridiksionit *ratione temporis* dhe *ratione materiae* të Panelit. Vërejtja e ngritur nga PSSP-ja rrjedhimisht hidhet poshtë.

20. Paneli konsideron se ankesa në bazë të nenit 2 të KEDNj-së ngritë çështje serioze të fakteve dhe të ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet në shqyrtimin e bazueshmërisë. Rrjedhimisht, Paneli vjen në përfundim se ankesa është e pabazuar në bazë të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

21. Nuk është përcaktuar ndonjë bazë tjetër për shpalljen e kësaj ankese si të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri,

SHPALL ANKESËN TË PRANUESHME

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues